

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, shpallet

## KONKURS

për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe për zgjedhje në thirrrje të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe për zgjedhjen në thirrrje të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës:

### FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

1. Një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e farmacisë.

### FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

1. Një mësimdhënës pér lëndët mësimore në fushën e fizikës;
2. Një asistent pér lëndët mësimore në fushën e matematikës;
3. Një asistent pér lëndët mësimore në fushën e informatikës.

### FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE

1. Një mësimdhënës pér lëndët mësimore në fushën e kulturës fizike.

### FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE DHE TË USHQYERIT

1. Një asistent pér lëndët mësimore në fushën e teknologjisë ushqimore.

### FAKULTETI PEDAGOGJIK

1. Një mësimdhënës pér lëndët mësimore në fushën e pedagogjisë.

#### Kushtet pér thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë pér gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
  - Kandidatët që konkurojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
  - Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
  - Biografi e shkurtër;
  - Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
  - Vërtetim pér njohjen e një gjuhe të huaj;
  - Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;

- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

#### **Kushtet për thirrjen e bashkëpunëtorit:**

- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
  - Kandidatët që konkurojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
  - Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
  - Biografi e shkurtër (CV);
  - Ta dorëzojë punimin e magjistraturës;
  - Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
  - Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
  - Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
  - Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore dhe të bashkëpunëtorëve, të parapara me nenet 166 dhe 170 të Ligjit për arsimin e lartë.

\*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

**Universiteti i Tetovës**